

 <b>ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS</b> <b>KOSOVO DOCTORS CHAMBER</b> <b>LEKARSKA KOMORA KOSOVA</b>	
Njësia:	Nr. Prot.:
Unit: <u>KEVP</u>	Prot. No.: <u>1933/2022</u>
Jednica:	Br. Prot.:
Nr. i faqeve:	Data:
No. of pages: <u>-03-</u>	Date: <u>24.05.2022</u>
Br. stranica:	Datum:
	Prishtinë/ë
	KEVP - KL



**ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS**  
 KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

**KOMISIONI AD HOC për përpilimin e kriterëve të konkursit publik dhe vlerësimin e punimeve shkencore**, në mbështetje të shtojcës III të Rregullores për Edukim të Vazhdueshëm Profesional pranë OMK-së si dhe Vendimit nr. 03/2022 të Këshillit Drejtues të OMK-së, duke iu referuar konkursit publik për përkrahje financiare të 10 (dhjetë) punimeve shkencore të shpallur me datë 14 shkurt 2022, në takimin e datës 24 Maj 2022 nxjerr këtë:

**VENDIM**

- I. **SHFUQIZOHET** vendimi nr. ref. 923/2022 i datës 21 Mars 2022, sipas shkresës rekomanduese nr. ref. 38/2022 të datës 12 Prill 2022 të Këshillit Drejtues të OMK-së.
- II. **RI-PËRPILOHET LISTA PRELIMINARE** për 10 (dhjetë) përfituesit e përkrahjes financiare të punimeve shkencore për vitin 2021, sipas kriterëve të komisionit për punime shkencore si në vijim:

Nr.	Emri dhe mbiemri i kandidatit	Totali i pikëve
1	Bernard Tahirbegolli	140.128
2	Ibadete Bytyqi	132.976
3	Albina Ponosheci-Biçaku	68.256
4	Gani Bajraktari	67.2
5	Artan Bajraktari	57.904
6	Kushtrim Grezda	45.12
7	Ilir Hoxha	43.072



8	Artan Ahmeti	36.32
9	Jeton Shatri	35.2
10	Bujar Shabani	34.8

- III. Përfituesit nga paragrafi II i këtij vendimi do të përkrahen financiarisht nga Oda e Mjekëve të Kosovës në shumë prej 1,000€, pas përfundimit të afatit ankimor prej 5 ditëve nga dita e këtij vendimi.
- IV. **Obligohet** Shërbimi Profesional i OMK-së, të publikojë këtë vendim në faqet zyrtare të OMK-së.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

### *Arsyetim*

Me datë 21 Mars 2022, Komisioni Ad-Hoc për përpilimin e kriterëve të konkursit publik dhe vlerësimin e punimeve shkencore, në takimin e datës 21 Mars 2022 ka nxjerr vendim për përzgjedhjen e 10 përfituesëve të përkrahjes financiare të punimeve shkencore për vitin 2021 konform kriterëve të caktuara nga vetë komisioni.

Me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi dhe publikimit të listës preliminare, palët e pakënaqura kanë pasur të drejtën e ankesës nëafat prej 5 (pesë) ditëve ndaj vendimit të Komisionit Ad-Hoc. Si rrjedhojë, brenda afatit të paraparë ligjor njëri nga palët e pakënaqura ka ushtruar të drejtën e ankesës pranë shkallës së dytë për shqyrtimin e ankesave, respektivisht pranë Këshillit Drejtues të OMK-së. Këshilli Drejtues i OMK-së me datë 12 Prill 2022 ka mbajtur takimin e rregullt në të cilin ka shqyrtuar ankesën e palës bashkë me dokumentet përcjellëse dhe me vendim unanim ka aprovuar të njejtën ku përmes shkresës rekomanduese obligon Komisionin Ad-Hoc për rishqyrtimin e të gjitha aplikacioneve për përkrahje të punimeve shkencore për vitin 2021.

Komisioni Ad-Hoc pas pranimit të shkresës rekomanduese nga Këshilli Drejtues i OMK-së, mban takimin e radhës me datë 24 Maj 2022 në të cilin rishqyrton të gjitha lëndët e pranuar brenda afatit të rregullt të konkursit për përkrahje të punimeve shkencore për vitin 2021. Rishqyrtimi i të gjitha lëndëve është bërë duke u bazuar në kriteret e komisionit ku janë përdorur si reference tri platforma kryesore për vlerësimin e punimeve shkencore si: Web of Science, Pub Med dhe Scopus. Impakt faktori i revistës është konsideruar impakt faktori i fundit i raportuar nga Web of Science.

Anda, Komisioni bazuar në shtojcën III të Rregullores për Edukim të Vazhdueshëm Profesional pranë OMK-së, Vendimit nr. 03/2022 të Këshillit Drejtues të OMK-së si dhe shkresës

rekomanduese nr. ref. 38/2022 të datës 12 Prill 2022 të Këshillit Drejtues të OMK-së vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

KOMISIONI AD-HOC PËR VLERËSIMIN E PUNIMEVE SHKENCORE

NR. I REF. 1933/2022 dt. 24.05.2022

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej pesë (5) ditëve nga dita e publikimit. Ankesa dorëzohet përmes Komisionit drejtuar Këshillit Drejtues të OMK-së.

Prishtinë, 24 Maj 2022

Kryetari i Komisionit Ad Hoc

Prof. Dr. Salih Ahmeti

